



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.91/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.91/2025, Anr.92/2025, Anr.94/2025, dhe Anr.104/2025 e datës 21.01.2025.

II. Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 21.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.91/2025, Anr.92/2025, Anr.94/2025, dhe Anr.104/2025, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë.

-Në ankesën Anr.91/2025 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me pretendon se më 20 janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje, në Istog ka identifikuar banerin/posterin i vendosur në rrugën hapësirat - rrugët publike "Rinia" në Istog të kandidatit

të AAK-së për deputet Ukë Blakaj. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

-Në ankesën A.nr.92/2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ukë Blakaj në afërsi të shtëpisë së Kulturës në Istog, në rrugën “Skënderbeu”. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

- Në ankesën A.nr.94/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ukë Blakaj në Gurakoc të Istogut, në rrugën “Besim Kabashi”. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

-Në ankesën A.nr.104/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), pretendon se Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) Ukë Blakaj, në rreth rrotullimin e rrugës “Lidhja e Prizrenit”, në Istog. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Parashtruesi i ankesave thekson se me këto veprime kandidati dhe subjekti politik AAK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Tutje parashtruesi i ankesës thekson se përmes këtyre veprimeve, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore dhe duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP, mes tjerash me vendimet Anr.48/2025, Anr.49/2025, Anr.50/2025, Anr.51/2025, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 22.01.2025 në ora 17:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 22.01.2025, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka kundërshtuar ankesat e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje paraqitur kundër kandidatit për deputet nga radhët e AAK-së, z. Ukë Blakaj. Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se kandidati për deputet z.Balaj ka vepruar në harmoni të plotë me nenin 44, par.1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së, i cili subjekteve politike dhe kandidateve të tyre, ua mundëson që: *"1,2. të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore"* Tutje, Rregullorja për Fushatën Zgjedhore nr.07/2024, në nenin 5, par.1.2, përcakton se: *"të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore"*.

Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se, bazuar në fotografitë e paraqitur si provë nga subjekti politik LVV në ankesat e saj, konstatohet se posterët në fjalë janë vendosur në një hapësirë reklamuese, e cila ka qenë e instaluar dhe funksionale edhe para nisjes së fushatës zgjedhore dhe se hapësirat e përmendura në ankesën Anr.91 shfrytëzohen rregullisht për qëllime reklamimi dhe nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore të cituara. Sipas përgjigjes në ankesë praktika e deritanishme e PZAP-së ka treguar se në rastet kur posterët politik janë vendosur në hapësira përcaktuara më herët për qëllime marketingu apo reklamimi, ato janë konsideruar të lejueshme, e gjithë kjo në harmoni me nenin 44, par.1 nën par.1.2 i LZP-së si dhe nenin 5, par.1.2 të Rregullores për Fushatën Zgjedhore nr.07/2024. Pra, është i pakundërshtueshëm fakti se ankesave të LVV-së iu mungon bazueshmëria juridike.

Më tutje parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se nëse njëmend misioni i PZAP-së është fuqizimi i demokracisë, që duke u përkushtuar me profesionalizëm, paanshmëri dhe në kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akterët lidhur me procesin zgjedhor, atëherë është më se jetike hedhja poshtë e gjitha pretendimeve ankimore të subjektit politik LVV. Andaj, në mungesë të bazueshmërisë juridike dhe arsyeshmërisë së ankesave të tyre, i ka propozuar organit shqyrtues të kësaj ankese, që të merr vendimin përmes së cilit, ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.91/2025, A.nr.92/2025, A.nr.94/2025 dhe A.nr.104/2025 të paraqitura me datë 21.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.91/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik AAK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga subjekti politik AAK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesat paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik AAK gjegjësisht e njëjta ka vendosur banerët/posterat në rrugë publike të kandidatit për deputet të këtij subjekti politik Ukë Blakaj, në rrugën “Rinia” në Istog, në rrugën “Skënderbeu” në afërsi të shtëpisë së Kulturës në Istog, në rrugën “Besim Kabashi në Gurakoc të Istogut” në rreth rrotullimin e rrugës “Lidhja e Prizrenit”, në Istog, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli shqyrtoi edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik AAK në të cilën e kundërshton ankesën dhe ku thekson se kandidati për deputet Ukë Balaj ka vepruar në harmoni me nenin 44, par.1 nën par.1.2 i LZP-së dhe nenin 5, par.1.2 të Rregullores për Fushatën Zgjedhore nr.07/2024, dhe ku thekson se hapësira e përmendur në ankesë shfrytëzohet rregullisht për qëllime reklamimi dhe nuk përbën shkelje të dispozitave ligjore të cituara, për Panelin këto pretendime janë të pabazuara dhe të pa argumentuara për faktin se nga përgjigja e ofruar nga subjekti politik AAK nuk ka arritur që ti vërtetoj me asnjë provë dhe dëshmi konkrete thëniet e pretenduar në përgjigjen e saj.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim, fillimisht faktin se në rastin konkret bëhet fjalë për disa shkelje të bëra në të njëjtën kohë, natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik për shkelje të natyrës së njëjtë i është shqiptuar gjohë nga PZAP-i, me Vendimin Anr.66/2025, të datës 20.01.2025.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një

atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 në paragraf 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.91/2025 më datën 23.01.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA


AA.nr.12/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Rustem Thaqi dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesave të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më dt.9.02.2025, duke vendosur sipas ankesës së Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.91/2025 dt.23.01.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.01.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.91/2025 dt. 23.01.2025.

A r s y e t i m



Me pjesën e I të dispozitivit të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.91/2025 të dt.23.01.2025, pranohen si të bazuara ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, A.nr.91/2025, A.nr.92/2025, A.nr.94/2025 dhe A.nr.104/2025 të dt.21.01.2025. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 10,000.00 euro. Me pjesën e III të dispozitivit të tij, detyrohet Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, që gjobën e shqiptuar si në pikën II të dispozitivit të vendimit, ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit.


Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP, Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me kohë ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, siç thuhet në të, për shkak se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, gjoba është shqiptuar përtej kapaciteteve të përcaktuara nga KQZ për Financimin e Subjekteve Politike dhe nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, me propozim që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i sipër cekur i PZAP-së dhe ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje të refuzohen, apo në rastin më të pavoritshëm ta ulë gjobën e shqiptuar apo rastin ta kthejë në PZAP për rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 21.01.2025 ka pranuar ankesat e paraqitura nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, të sipër përmendura, (si në dispozitivin dhe arsyetimin e vendimit), të parashtruara kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilat pretendojnë se më dt.20.01.2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje ka



identifikuar banerin / posterin i vendosur në rrugën hapësirat – rrugët publike “ Rinia” në Istog të kandidatit të AAK-së për deputet Ukë Blakaj, duke bashkangjitur për provë një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit / posterit në kundërshtim me LZP, po ashtu, ka identifikuar banerin / posterin e vendosur në hapësirat publike / rrugët publike të kandidatit për deputet nga radhët e AAK-së, Ukë Blakaj, në afërsi të Shtëpisë së Kulturës në Istog, në rrugën “Skenderbeu”, duke i bashkangjitur si provë një fotografi, si më sipër, gjithashtu, në mënyrën e njëjtë, në Gurrakoc të Istogut, në rrugën “ Besim Kabashi” me një fotografi si provë, dhe në mënyrë të njëjtë, për të njëjtin kandidat për deputet, edhe në rreth rrotullimin e rrugës “Lidhja e Prizrenit” në Istog, me një fotografi të bashkangjitur si provë. Ndërsa, më tej, PZAP, ka konstatuar se paraqitësi i ankesave, ka theksuar se me këto veprime kandidati dhe Subjekti Politik AAK, kanë bërë shkelje të nenit 34 par.1 , nënp.1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore, ndaj, ka kërkuar që në mbështetje të dispozitave ligjore dhe praktikës së PZAP-së, masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nëpërmjet përgjigjes në ankesë, më dt.22.01.2025, Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka kundërshtuar ankesat e paraqitura nga Subjekti Politik LVV, paraqitur kundër kandidatit për deputet nga radhët e AAK-së, Ukë Blakaj, duke theksuar se i njëjti ka vepruar në harmoni të plotë me nenin 44 par.1, nënp.1.2 i LZP-së, dhe Rregullores për Fushatën Zgjedhore nr.07/2024, nenit 5, par.1.2, duke i cituar në të, të njëjtat dispozita, sipas së cilës, posterët në fjalë janë vendosur në një hapësirë reklamuese, e cila ka qenë e instaluar dhe funksionale edhe para nisjes së fushatës zgjedhore dhe se këto hapësira shfrytëzohen rregullisht për qëllime reklamimi dhe se nuk përbën shkelje të dispozitave të sipër përmendura ligjore dhe së ankesat, si të tilla, duhet të refuzohen si të pa bazuara.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia konform dispozitave të nenit 9 par.5, nënp.5.5 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-së dhe nenit 84 par.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat e lartë cekura të parashtruesit të ankesave, LVV, duke i trajtuar të njëjtat me një vendim, kjo për shkak të natyrës së njëjtë të çështjes, të parashtruara nga Subjekti i njëjtë politik, LVV, kundër Subjektit të njëjtë politik, AAK,



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik AAK, ka vlerësuar se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovojë, për faktin sepse veprimet e përshkruara si më sipër, në ankesat e saj, paraqesin shkelje nga ana e Subjektit Politik AAK, kur e njëjta ka vendosur banerët / posterët në rrugë publike, të kandidatit për deputet të këtij Subjekti Politik, Ukë Blakaj, me të dhënat tjera, si në ankesat e përshkruara më lartë, me të cilat veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 par.1, nënp.1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Ligji Nr.08/L-228), ku parashihet se “ Vendosja e njoftimeve, pllakatave dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”.

Në këtë gjendje të çështjes faktike të vërtetuar kësi soji, PZAP ka gjetur se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me veprimet e sipër përmendura ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 34 par.1, nënp.1.2 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ndaj, në bazë të nenit 117 par.3, nenit 118 par.1, dhe nenit 120 par.1, nënp.1.3 të LZP-së, këtij Subjekti Politik i ka shqiptuar gjobën në lartësi prej 10,000.00 euro, si në dispozitiv të vendimit të sipër cekur të dt.23.01.2025. PZAP, me rastin e vendosjes për gjobën dhe lartësinë e saj si në dispozitiv të vendimit, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim; fillimisht faktin se në rastin konkret bëhet fjalë për disa shkelje të bëra në të njëjtën kohë, natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo i ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se Subjekti Politik AAK ka qenë i njoftuar me detyrimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjit zgjedhor në fuqi që ka bërë ky Subjekt në këto zgjedhje, pra, ka qenë i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe të njëjtit Subjekt, për shkelje të natyrës së njëjtë, i është shqiptuar gjobë nga PZAP-i me vendimin A.nr.66/2025 të datës 20.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar



lidhur me shqiptimin e gjobës ndaj Subjektit Politik AAK, me që vendimi i të njëjtit organ nuk është i kundërligjshëm, është i bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, në dispozitat e sipër cituara ligjore. Vendimi i PZAP-së, është marrë pasi që më parë, në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ndaj, veç tjerash, nga këtu, dhe në përputhje me dispozitat e nenit 120, përkatësisht, par.1, nënp.1.3, LZP-së, me të cilin parashihet se PZAP në rast se përcakton që ka ndodhur shkelje e këtij Ligji..., mund të “vendos një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro”, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret juridik, kur PZAP, me të drejtë këtij subjekti politik i ka shqiptuar gjobën në lartësi si në dispozitiv të vendimit të sipër përmendur.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, përkatësisht, shkeljet e dispozitave përkatëse të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, etj, mirëpo, në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme. Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe më lartë, veç tjerash, PZAP me rastin e shqiptimit të gjobës përkatëse, për shkeljen e sipër përmendur, ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar një mori të rrethanave të specifikuara në arsyetimin e vendimit të vet dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë të Kodit të Mirësjelljes....(sipas nenit 120, par.1, nënp..3 LZP) është deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro, nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se vendimi për gjobën e shqiptuar këtij Subjekti Politik (AAK-së) në lartësi prej 10,000.00 euro, është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në kontekstin e mësipërm, në pajtim me parimin e proporcionalitetit, me rrethanat dhe kriteret përkatëse ligjore, me të cilin do të arrihet qëllimi ligjor i shqiptimit të këtij sanksioni, jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe te subjektet tjera politike që marrin pjesë dhe garojnë në këto zgjedhje, që me përpikëri të respektojnë dhe të zbatojnë dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe rregullat tjera zgjedhore në fuqi.



Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e ankimuar të PZAP-it, i cili, për arsyet e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo Gjykatë, ankesën e paraqitur nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kundër vendimit të kontestuar, e refuzoi si të pa themeltë.

Nga arsyet e sipër përmendura , e në pajtim me dispozitën e nenit 118 pika 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.12/2025 dt. 27.01.2025

Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
**SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE**

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik